



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 25/2023

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues, Franciska Zhitija Ymeri dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e B.B, kryetar i këshillit të përgjithshëm të Partisë Demokratike Vatan me seli në Dragash, të paraqitur ndaj përgjigjes së Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Partive Politike (Zyra), me Nr.prot. 1610 të datës 30.03.2023, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji nr.03/L-073), dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të Rregullores nr. 1/2023 për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.25/2023 e datës 04.04.2023, e paraqitur nga B.B, kryetar i këshillit të përgjithshëm të Partisë Demokratike Vatan me seli në Dragash, ndaj përgjigjes së Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Partive Politike (Zyra), me Nr.prot. 1610 të datës 30.03.2023.

A r s y e t i m

Me datën 04.04.2023, **PZAP-i**, ka pranuar ankesën e paraqitur përmes postes nga B.B, kryetar i këshillit të përgjithshëm të Partisë Demokratike Vatan me seli në Dragash, i cili thekson se ka paraqitur kërkesë nr.1510 me datën 01.02.2023, pranë Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, për pezullim të Partisë Demokratike Vatan - me seli në Dragash, për shkak të shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe Rregullës Zgjedhore nr. 01/2013 Për regjistrimin dhe punën e partive politike. Gjithashtu thekson se më datë 27.02.2023, ka parashtruar ankesë me nr.prot.1544, në zyrën për regjistrim, certifikim dhe kontroll financiar të subjekteve politike, për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe shkeljet e dispozitave të Rregullës Zgjedhore Nr. 01/2013, për pezullim të partisë politike të Partisë Demokratike Vatan me seli në Dragash.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me datë 30 mars 2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, më numër prot. 1610-2023, me deklaratën se kryetari i Partisë Demokratike Vatan, me seli në Dragash, A.R, ka shkelur në disa raste Statutin e Partisë Demokratike Vatan, ndërsa pezullimi i partisë politike nuk është kryer për arsyet që janë paraqitur në formë ankese nga kërkuesi, si dhe se rastet e pezullimit të partisë politike nuk iniciohen me kërkesë nga palët e jashtme.

Andaj për shkak të gjithë të cekurave si më sipër, parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP-i, të anulojë përgjigjen në ankesë, dhe të pezullojë Partinë Demokratike Vatan me seli në Dragash.

Në përgjigjen në ankesë nga Zyra- KQZ, të datës 05.04.2023, theksohet se lidhur me përgjigjen në ankesën me numër A.nr. 25/ 2023, e datës 04.04.2023, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (tutje Zyra) në vijim paraqet shpjegimin, që lidhet me shqyrtimin e dokumentacioneve si: të dhënat nga formulari i azhurnimit vjetor, i dorëzuar deri më 31 janar 2022, të dhënat nga formulari i azhurnimit vjetor, i dorëzuar deri më 31 janar 2023, ankesa e dorëzuar në Zyre, me datën 27.02.2023 nga B.B, shqyrtimi i statutit të partisë politike Demokratska Stranka Vatan, me rastin e përgjigjes (përgjigja e datës 30.03.2023, me numër të protokollit 1610-2023) në ankesën që e ka dorëzuar në Zyrë, z. B.B, e datës 27.02.2023, me numër të protokollit: 1544/ 2023.

Sa i përket formularit të azhurnimit vjetor të partive politike 2022 dhe 2023, Partia politike Demokratska Stranka Vatan, në vitin 2022, kishte dorëzuar formularin e azhurnimit vjetor, me datën 19.01.2022, që përmban vulën e protokollit 1237-2022, dhe formularin e azhurnimit vjetor 2023, me datën 31.03.2023, që përmban vulën e protokollit 1482-2023, me emrat dhe mbietrat e anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv.

Sa i përket ankesës së dorëzuar në Zyrë, me datën 27.02.2023 nga B.B, anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Partisë Politike Demokratska Stranka Vatan, me arsyetimin se katër (4) anëtarët e këtij këshilli, janë zëvendësuar në kundërshtim me statutin e partisë politike, ku përmes kësaj anekese, z. B.B (si palë ankuese) ka kërkuar pezullimin e partisë politike Demokratska Stranka Vatan, sipas përgjigjes së Zyrës, që mban datën 30.03.2023, me numër të protokollit 1610/2023, pala ankuese (B.B) është njoftuar se pezullimi i partisë politike nuk inicohet nga palët e jashtme.

Ndërsa sa i përket shqyrtimit të statutit të partisë politike Demokratska Stranka Vatan, në përgjigjen në anekese nga Zyra theksohet se me datën 27.02.2023, Zyra ka pranuar ankesën nga B.B, anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Partisë Politike, me arsyetimin se katër (4) anëtarët e këtij këshilli, janë zëvendësuar në kundërshtim me statutin e partisë politike, Zyra ka konstatuar si në vijim: a) sipas nenit 32 të statutit të partisë politike Demokratska Stranka Vatan, prej katërmëdhjetë (14) kompetencave të kryetarit të partisë politike, asnjëra nga këto nuk thekson se Kryetari i partisë politike mund të zëvendësoj anëtarët e Këshillit Ekzekutiv, b) sipas nenit 28 të statutit të partisë politike Demokratska Stranka Vatan, Këshilli i Përgjithshëm (si organi më i lartë ekzekutiv) zgjedh anëtarët e Këshillit Ekzekutiv dhe në këtë kuptim, vetëm Këshilli i Përgjithshëm ka kompetencë të shpërndajë Këshillin Ekzekutiv, dhe me këtë nënkuptohet se zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv duhet të përcillet me procedurat e njëjta, duke u votuar nga Këshilli i Përgjithshëm. Në lidhje me këtë Zyra, të njëjtën përgjigje (1610/ 2023, datë 30.03.2023) ia ka dërguar edhe kryetarit të partisë politike Demokratska Stranka Vatan, se zëvendësimet e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv, janë në kundërshtim me statutin e partisë politike.

Në përgjigjen në anekese nga A.R, kryetar i Partisë Demokratike Vatan, theksohet se bazuar në rregulloren e KQZ-së, është detyrë e secilës parti të dorëzojë çdo vit një formular për përditësimin e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm. Për shkak të disa mosmarrëveshjeve të brendshme në krye të partisë, anëtari i lartpërmendur i Këshillit të Përgjithshëm shprehu bojkotimin e tij duke refuzuar të marrë pjesë në tri mbledhjet e fundit të Këshillit Ekzekutiv dhe duke refuzuar të nënshkruajë formularin e lartpërmendur të cilin është i obliguar për të

nënshkruar. Duke pasur parasysh se sipas rregullës së KQZ-së, formulari është i vlefshëm nëse nënshkruhet nga dy të tretat e anëtarëve, kryetari i partisë e ka dorëzuar formularin pa nënshkrimin e B. të lartpërmendur dhe dy anëtarëve të tjerë të Këshillit të Përgjithshëm, U.H dhe I.H, të cilët ndanë të njëjtin mendim. Nuk ka pasur zëvendësim apo përjashtim të personave të përmendur në ankesë, gjë që mund t'i kontrollojë në formularët që ne i kemi dorëzuar në mënyrë të rregullt në Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike. Me vendim të partisë më 07.11.2022. dy anëtarë të Këshillit Ekzekutiv u kooptuan për shkak se anëtarët e mëparshëm J.H dhe S.A u larguan nga Republika e Kosovës dhe u shpërngulën në Itali.

Me vendim, në përputhje me statutin e DSV-së, neni 38, me datë 04.01.2023. anëtarët e komisionit statutor janë zëvendësuar (në përputhje me nenin 38 të statutit të partisë, i cili thotë se "anëtarët e komisionit statutor nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të një organi tjetër të partisë"). Pas sa më sipër, B.B, i pakënaqur për shkaqe të njohura vetëm për të dhe në kundërshtim me rregulloren e punës dhe statutin e partisë, ka paraqitur ankesë në Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike, nga e cila kemi marrë rekomandime të cilat do t'i zbatojmë plotësisht.

Theksojmë se asnjë nga anëtarët e lartpërmendura në ankesë nuk është zëvendësuar apo përjashtuar nga DSV dhe se çdo keqkuptim duhet të zgjidhet brenda DSV-së në përputhje me statutin dhe rregullat e punës së partisë.

Ka rregulla të qarta që parashikojnë punën e secilës parti, në të cilat asnjë individ nuk ka të drejtë të kërkojë mbylljen e saj sepse partia ka marrë mandate nga delegatët e saj legjitimë në asamblenë e partisë, theksohet në përgjigjen në ankese nga Partia Demokratike Vatan.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën e parashtruar nga pala konstatoj se:

Ankesa është e pa lejuar

Ankuesi z.B.B, kryetar i këshillit të përgjithshëm të Partisë Demokratike Vatan me seli në Dragash, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilin ka kërkuar anulimin e përgjigjes Nr.1610-2023, të datës 30.03.2023, të Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, si dhe ka kërkuar që të pezullohet subjekti politik Partia Demokratike Vatan - me seli në Dragash, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji nr. 003/L-073), zbatim i gabuar i dispozitave të Rregullores nr. 1/2023 për Regjistrimin dhe Punën e Partive Politike.

Në dispozitat ligjore të LZP-së përcaktohet qartë se në cilat raste apelimet zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, mund të paraqiten në PZAP, ku edhe janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- a) *Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;*
- b) *Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;*
- c) *Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;*
- d) *akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;*
- e) *vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe*

- f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të lartcekura rezulton se në cilat raste mund të apelohe vendimet e KQZ-së, dhe në këtë rast ndaj njoftimeve të tilla të bëra nga Zyra, nuk janë të apelueshme përveç nëse parashihen qartë më ligj, prandaj në këtë rast njoftimi në fjalë nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apelohe e të cilat janë të përcaktuara si më lartë.

Lidhur me kërkesën për pezullimin e subjekteve politike, me Rregullën Zgjedhore të KQZ-së nr. 01/2023, Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike, e miratuar me datë 09.03.2023, përcaktohen në mënyrë të qarte rastet se kur dhe si pezullohet një subjekt politik.

Dispozitat e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së, nr. 01/2023, specifikon se pezullimin mund ta bëjë vetëm KQZ, në qofte se subjektet politike nuk i mbajnë konventat/kuvendin e partisë politike, nuk e kanë njoftuar Zyrën për mbajtjen e konventës/kuvendit, dhe nuk i kanë dorëzuar raportet e përditësuar dhe të kompletuara vjetore deri me 31 Janar të çdo viti.

Gjithashtu PZAP, bazuar në nenin 4 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2022 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave dhe Apeleve, konstaton se kërkesat e tilla të paraqitura nga palët e tjera si të tilla janë të palejuara.

Andaj, nisur të gjitha arsyet e paraqitura si më sipër, në pajtim me nenin 118 të LZP-së, nenin 4 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2022 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave dhe Apeleve, si dhe Rregullën Zgjedhore të KQZ-së nr. 01/2023 Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 25/2023 më datën 06.04.2023.

Kryesues i Panelit

Ferki Xhaferi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.